

## **Pacolli: Zv.ministri i Drejtësisë ‘vodhi’ Alsat**

Së pari, ju falënderoj për impenjimin tuaj, e sidomos në luftën që bëni pa kompromise për vendosjen e shtetit ligjor dhe Drejtësinë në Shqipëri. Jam i bindur se askush më mirë se ju nuk e ndihmon funksionimin e mirë të institucioneve në një shtet që aspiron të ndërtojë demokracinë. Unë e kuptoj qartë se shoqëria shqiptare vazhdon të vuajë shumë atë kulturë totalitare që ka prodhuar mungesë objektiviteti në të kaluarën. Kjo reflektohet qartë në mënyrën se si funksionojnë institucionet. Mjafton të kujtoj faktin se KKRT-ja, një ndër institucionet e rëndësishme që rregullon marrëdhëniet e mediave në Shqipëri, mban standarde të dyfishta për mediat që ndihmojnë qeverinë apo që kanë impakte të fshehura me të. Jam shumë i çuditur që kryetari i KKRT-së në vend të më kthejë përgjigje zyrtarisht për mosnjohjen e qëllimshme të aksioneve të mia dhe, mbi të gjitha, për dezinformim të shtypit dhe shtetit, zgjedh të më përgjigjet me anën e mediave. Mësova se sipas tij, unë e paskam fajin që nuk kam njoftuar blerjen e aksioneve dhe nuk kam bërë regjistrimin në KKRT. Dua t'i kujtoj zotit Bianku se mosregjistrimi i aksioneve të mia është një akt i qëllimshëm i zonjës Mira Meksi, e cila gjatë gjithë kohës është përpjekur, në bashkëpunim me Vebi Velinë, të më grabisin pronën. Kjo është tejet e vërtetë. Mjafton t'ju tregoj se ajo, në bashkëpunim të ngushtë me Vebi Velinë dhe Eduart Halimin, avokat i VEVE-së dhe Alsatit, kishin hartuar një strategji të plotë grabitjeje. Kur bleva aksionet e Alsatit, këtë të fundit e gjeta me barra në Hipotekë dhe

kërkova që me pagesën e këstit të fundit, godina e Alsatit të lirohej nga detyrimi kundrejt Bankës Amerikane. Gjë që nuk është bërë kurrë. Madje, nga verifikimet e mëvonshme, mësova që pasuria e patundshme e shoqërisë Alsat sha a, nuk është në emër të shoqërisë Alsat sh.a, por në emrin e Vebi Velisë. Edhe kur e kam kërkuar këtë gjë në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, më është premtuar vazhdimisht se këto veprime do të bëheshin. Më rezultoi se nuk u bënë asnjëherë. Madje, zonja Mexi falsifikoi edhe dokumentin e Hipotekës. Skenari i kësaj grabitjeje vazhdon më pas me drejtuesin e KKRT-së, që legjitimon këtë vjedhje duke më mohuar mua pronësinë mbi Alsat sha, edhe pasi e kisha vënë në dijeni me kërkesën ankimore të depozituar pranë këtij institucioni në datën 15.11.2006, me numër prot.

1130. Duke dashur të jem përherë me ligjin dhe në zbatim të plotë të tij, e kërkova këtë gjë nga Bianku që të vendosë të respektojë detyrimin ligjor që i ngarkon pozicioni i tij. E falënderoj zotin Bianku që më vë në dijeni përmes një njoftimi për median, se sipas nenit 20 të ligjit nr 8410, nuk më lejohet të kem më shumë se 40% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë. E drejtë, por dua t'ju sqaroj se kur i bleva aksionet, avokat Eduart Halimi, edhe pse shumë i famshëm në profesion, sepse kot nuk e vunë si zv/ministër të Drejtësisë shqiptare po mos t'i kishte këto aftësi, nuk më njoftoi për këtë gjë. Thua nuk e dinte? Gjithsesi, edhe në këtë rast, kur u informova për ligjin shqiptar, kërkova në Këshillin Mbikëqyrës, mbajtur në Lugano, në 29.10 2005, ristrukturimin e aksioneve sipas ligjeve shqiptare, duke ia kaluar 35% të aksioneve z.Afrim Pacolli. Për këtë gjë, Këshilli Mbikëqyrës pasi ra dakord, vendosi të ngarkojë avokat Eduart Halimin për të kryer veprimet në regjistrin

tregtar. Edhe ky veprim nuk u bë atëherë dhe akoma nuk është bërë, si pasojë e qëllimeve keqdashëse të zotit Velia, që duket se tashmë ka mbështetjen e ca institucioneve shtetërore. Nuk dua ta besoj, por jam i shqetësuar se i gjithë ky skenar për të më grabitur pronën ka përfshirë edhe gjykatat shqiptare, që me vendimet e tyre kanë bllokuar të drejtën time për të drejtuar shoqërinë, duke bllokuar regjistrimin e të gjitha vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës dt 8 .4. 2006, për pezullimin e menaxheres Mira Meksi dhe vendosjen e një drejtuesi të ri. Nuk arrij ta kuptoj sesi i gjithë ky skenar që mban vulën e këtyre personave, arrin deri në nivele të tilla. Arsyet e këtyre veprimeve arbitrare dhe mbështetja që u jepet atyre, më duket e qëllimshme. Nga sa kam informata, kam konstatuar edhe veprime të tjera abuzive të Vebi Velisë, i cili duke u sjellë si pronar i Alsatit, siç e njeh edhe KKRT-ja, ka ndërmarrë kontakte me kompani austriake dhe gjermane për shitjen e aksioneve të Alsatit, duke vijuar me afera mashtrimesh. Nuk di se përse ky individ vijon të mbrohet nga ca institucione. Papërgjegjshmëria dhe korrupsioni që ka përfshirë institucionet jo pak herë janë bërë objekt i medias shqiptare. Madje, një prej kërkesave imediate që ndërkombëtarët na kanë vënë si detyrë dhe kusht për përfshirjen e Shqipërisë në proceset integruese me synim pjesëmarrjen e saj në BE, është edhe lufta kundër korrupsionit, një fenomen ky që po mban peng zhvillimin e vendit, po frenon investimet e huaja dhe mbi të gjitha, po penalizon rëndë të gjithë shoqërinë shqiptare. (Balkanweb)